



Tiranë, më 16 Qershor 2026

Emërtimi dhe Forma Ligjore: Fondacioni ALBANIAN BESA CAPITAL

Aktiviteti: Veprimtari të Organizatave Jo- Fitimprurëse

NIPT-i: K 92431451 E

Adresa: Rr. “Dritan Hoxha”, Laprakë, Tiranë

Tel. +355 4 2 253 841/842
www.abcfoundation.info
info@abcfoundation.info

RAPORTI I PERFORMANCËS – VITI 2025

PËRMBAJTJA

FAQE

➤	Informacion i përgjithshëm	3
➤	Objektivat dhe aktivitetet	4
➤	Arritjet dhe performanca	6
➤	Raportimi financiar	13
➤	Struktura, drejtimi dhe mbikqyrja	18
➤	Synimet për të ardhmen	20

➤ INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Fondacioni Albanian Besa Capital, është një organizatë jofitimprurëse, rregjistruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin Nr. 287, datë 19/09/2008 dhe pajisur nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me Certifikatën e Rregjistrimit me numër identifikimi NIPT: K 92431451 E, me adresë të veprimtarisë: Rr. “Dritan Hoxha”, Laprakë, Tiranë.

Fondacioni “ALBANIAN BESA CAPITAL” është një organizatë jofitimprurëse pa anëtarësi, e pavarur jo qeveritare, jo politike, e krijuar me vullnet të lirë nga themeluesit, të cilët nuk ndjekin qëllime fitimi dhe është i hapur për të gjithë ata që punojnë për realizimin e qëllimeve të tij. Fondacioni ABC ushtron aktivitetin si fondacion konform Statutit, Aktit të Themelimit dhe Legjislacionit Shqiptar në fuqi. Drejtimi i Fondacionit ABC bëhet nga Bordi Drejtues dhe Drejtori Ekzekutiv si përfaqësues ligjor i Fondacionit me të tretët.

Qëllimi i krijimit të Fondacionit Albanian Besa Capital është:

- Dhënia e ndihmës në formë grantesh grupeve në nevojë, me qëllim angazhimin dhe përmirësimin e jetës social ekonomike të këtyre grupeve.
- Nxitja dhe zhvillimi i veprimtarive ekonomike të subjekteve juridike dhe fizike, të cilët veprojnë në fushën e biznesit të vogël dhe të mesëm në Shqipëri, duke dhënë mbështetje financiare për krijimin e vendeve të reja të punës dhe vetëpunësimin, nxitjen e sipërmarrjes private, zhvillimin, promovimin dhe zgjerimin e aktivitetit të këtyre entiteteve, duke i nxitur ato për iniciativa të sipërmarrjes private me qëllim zhvillimin ekonomik dhe social në vend.
- Mbështetja e shoqërisë civile dhe grupeve të interesit me qëllim përmirësimin e klimës së biznesit në Shqipëri.

Për realizimin e qëllimeve të mësipërme, objekte të veprimtarisë së Fondacionit ABC, janë:

1. Realizimi i seminareve dhe trajnimeve me subjektet private që operojnë në fushën e biznesit të vogël dhe të mesëm;
2. Publikimi i materialeve të ndryshme me përmbajtje profesionale në ndihmë të subjekteve që ushtrojnë veprimtari ekonomike si biznes i vogël apo i mesëm;
3. Sigurimin e kryerjes së kualifikimeve dhe të asistencës teknike për personat fizikë dhe juridikë, si dhe dhënia e asistencës teknike personave fizikë dhe juridikë me praktika të mirë-administrimit të biznesit;
4. Kryerja e studimeve dhe vëzhgimeve në sektorin e veprimtarisë së personave fizikë dhe juridikë;
5. Kryerja e studimeve, vëzhgimeve dhe kërkimeve për sektorë apo degë të veçanta në shërbim për të nxitur sipërmarrjen private në Shqipëri.
6. Realizimi i politikave rekomanduese që ndihmojnë veprimtarinë e personave fizikë dhe juridikë;
7. Dhënia e ndihmës për realizimin e marrëdhënieve publike dhe publiciteti për personat fizikë dhe juridikë;
8. Zhvillimi aktivitetesh ekonomike dhe jo ekonomike që mbështesin qëllimet kryesore të Fondacionit;
9. Pjesëmarrja në Institucionet Financiare dhe në Shoqëri Tregtare me objekt veprimtarie të ndryshme si dhe të çdo lloji dhe forme organizimi.

10. Dhënia e ndihmës, kryesisht në formë grantesh për grupet në nevojë nëpërmjet mbështetjes dhe angazhimit të tyre në veprimtari për përmirësimin e jetës social-ekonomike. Mbështetje dhe ndihmë në ngritjen e sipërmarrjeve të vogla dhe familjare në fusha të ndryshme të ekonomisë.
11. Zhvillimi i aktiviteteve dhe veprimtarive për nxitjen e sipërmarrjes për të rinjtë e sapodiplomuar dhe të papunë, si grup në nevojë, me qëllim integrimin e tyre në jetën social-ekonomike.
12. Mbështetje financiare dhe me investime për sistemin arsimor, me qëllim përmirësimin e kushteve dhe të infrastrukturës, në favor të përfituesve të drejtpërdrejtë.
13. Zhvillimi i aktiviteteve për përmirësimin e mjedisit dhe zhvillimit të turizmit duke forcuar kapacitetet turistike familjare dhe lokale, duke i dhënë përparësi zonave potenciale, por në vështirësi ekonomike.
14. Nxitjen dhe zhvillimin e agroturizmit, mbështetjen financiare të subjekteve tregtare që kanë të bëjnë me prodhimin dhe tregtimin e prodhimeve bujqësore, blegtorale dhe ngritjen e industrisë agropërpunuese.

➤ OBJEKTIVAT DHE AKTIVITETET

Fondacioni Albanian Besa Capital (ABC), në përmbushje të misionit dhe qëllimit për të cilin është themeluar, synon të kontribuojë në realizimin e objektivave të tij statutore nëpërmjet mbështetjes financiare të ofruar përmes skemave të grantdhënies. Nëpërmjet kësaj qasjeje, Fondacioni parashikon të gjenerojë ndikim pozitiv në zhvillimin ekonomik, social, kulturor dhe në fusha të tjera me rëndësi për shoqërinë shqiptare.

Në funksion të këtij misioni, Fondacioni ABC ka hartuar Programin e Veprimeve për vitin 2025, në përputhje me qëllimet statutore, prioritetet strategjike dhe nevojat e identifikuara në komunitet. Programi synon të krijojë mundësi për zhvillimin e sipërmarrjes, fuqizimin institucional të sektorit të mikrofinancës, si dhe mbështetjen e grupeve në nevojë dhe organizatave që veprojnë në interes të komunitetit.

Programi i Veprimeve për vitin 2025 mbështetet në tre shtylla kryesore strategjike:

1. Përmirësimi i klimës së biznesit;
2. Ndërtimi i kapaciteteve për sektorin e mikrofinancës;
3. Mbështetja e shoqërisë civile, grupeve në nevojë dhe strukturave vendore.

Këto prioritete janë shoqëruar me planifikimin e burimeve financiare përkatëse, duke i dhënë një vëmendje të veçantë ndërhyrjeve që synojnë përmirësimin e klimës së biznesit dhe nxitjen e zhvillimit ekonomik. Kjo qasje reflektohet si në shpërndarjen e planifikuar të fondeve, ashtu edhe në përzgjedhjen e tematikave dhe fushave prioritare të ndërhyrjes.

Në kuadër të shtyllës **“Përmirësimi i klimës së biznesit”**, Fondacioni ka planifikuar të mbështesë iniciativa që synojnë zhvillimin e kulturës sipërmarrëse dhe krijimin e mundësive të reja ekonomike. Në këtë drejtim, është parashikuar mbështetja e projekteve të fokusuara në zhvillimin e sipërmarrjes rinore, ose në fuqizimin e sipërmarrjeve të sapokrijuara. Këto ndërhyrje synojnë rritjen e aftësive praktike, promovimin e inovacionit dhe përmirësimin e aksesit të të rinjve në mundësi ekonomike.

Gjithashtu, Fondacioni ka planifikuar të mbështesë **sipërmarrjen femërore**, veçanërisht iniciativat e orientuara drejt biznesit social, me synim përmirësimin e statusit social dhe ekonomik të grave dhe vajzave. Përmes kësaj mbështetjeje synohet rritja e pjesëmarrjes së tyre në aktivitetin ekonomik dhe promovimi i modeleve të biznesit që gjenerojnë ndikim pozitiv në komunitet.

Në kuadër të shtyllës së dytë, “**Ndërtimi i kapaciteteve për sektorin e mikrofinancës**”, Programi i Veprimeve 2025 parashikon zhvillimin e aktiviteteve të orientuara drejt forcimit të kapaciteteve profesionale dhe institucionale të institucioneve të mikrofinancës (IMF). Për këtë qëllim, janë planifikuar trajnime dhe aktivitete të zhvillimit profesional, të cilat synojnë përmirësimin e njohurive dhe aftësive të stafit të këtyre institucioneve, si dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara.

Po ashtu, Fondacioni ka parashikuar ofrimin e **mbështetjes financiare për aktivitete marketingu**, me qëllim rritjen e vizibilitetit të sektorit të mikrofinancës, promovimin e shërbimeve financiare gjithëpërfshirëse dhe forcimin e komunikimit me grupet e interesit.

Shtylla e tretë e Programit të Veprimeve, “**Mbështetja e shoqërisë civile, grupeve në nevojë dhe strukturave vendore**”, synon të adresojë nevoja të rëndësishme sociale dhe komunitare. Në këtë kuadër, Fondacioni ka planifikuar mbështetjen e projekteve që kontribuojnë në përmirësimin e statusit social dhe ekonomik të shtresave në nevojë, bazuar në nevojat e identifikuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Këto ndërhyrje parashikohet të përfshijnë, ndër të tjera, mbështetje për fëmijët, të moshuarit dhe kategori të tjera të cenueshme të popullsisë.

Gjithashtu, Programi parashikon mbështetjen e iniciativave që synojnë **fuqizimin e rolit të të rinjve në procesin e integritit europian**, përmes aktiviteteve që promovojnë njohjen me vlerat dhe parimet e Bashkimit Europian, nxisin qytetarinë aktive dhe inkurajojnë pjesëmarrjen e të rinjve në proceset zhvillimore të vendit.

Për më tepër, Fondacioni ka parashikuar mundësinë e financimit të **projekteve emergjente**, me qëllim krijimin e fleksibilitetit të nevojshëm institucional për t’iu përgjigjur situatave të paparashikuara dhe nevojave urgjente që mund të lindin gjatë vitit.

Në tërësi, Programi i Veprimeve për vitin 2025 pasqyron angazhimin e Fondacionit Albanian Besa Capital për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social në Shqipëri. Nëpërmjet ndërhyrjeve të planifikuara në fushën e sipërmarrjes, forcimit të sektorit të mikrofinancës dhe mbështetjes së iniciativave me ndikim shoqëror, Fondacioni synon të kontribuojë në krijimin e mundësive të barabarta, përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve dhe forcimin e kapaciteteve të aktorëve që veprojnë në funksion të interesit publik.

➤ **ARRITJET DHE PERFORMANCA**

Aktivitetet e grantdhënies të realizuara gjatë vitit 2025 janë si më poshtë vijon:

Natyra e Projekteve	Fusha	Nr. Projekteve	Titulli i Projektit	Grantmarrësi	Shuma e dhënë nga ABC (Lekë)
1. Projekti fitues (bazuar në procesin e thirrjeve të hapura)	Sipërmarrja Femërore/ Biznesi social	1	Art Turizëm	Shoqata Kombëtare për Integrim, Zhvillim dhe Ndihmë për Shtresat në Nevojë “SH.K.I.ZH”	700,000
2. Marrëveshje Granti (sponsorizime)	Ndërtim Kapacitetesh për Mikrofinancën	1	Trajnim i Stafit Drejtues të Fondit Besa mbi “Drejtimin, Menaxhimin e Ekipit”	Fondi Besa	170,000
	Përmirësim i infrastrukturës mbështetëse	1	Mobilimi i zyrave të reja të Shoqatës (AMA)	Shoqata Mikrofinanca Shqiptare	98,000
	Botime për Kërkime dhe Studime akademike	1	“Gjeneza e besimit, riskut, kredise” dhe “Menaxhimi në Mikrofinancë”	Adnand Zaloshnja	449,000
3. Grante Emergjence/të tjera	Përmirësim i infrastrukturës mbështetëse	1	Për ribrandimin dhe promovimin e imazhit të ri të ASF	Agro Social Fund	2,000,000
	Mbështetje për institucione publike	1	Panairi i produkteve artizanale të Bashkisë Skrapar “Skrapari në Gotë”	Përfituesi: Bashkia Skrapar	290,190
TOTAL		6			3,707,190

Të dhënat mbi realizimin e programit të granteve, të bazuara në kontratat dhe/ose marrëveshjet e lidhura gjatë periudhës janar – dhjetor 2025, të pasqyruara në tabelën përmbledhëse të mësipërme dhe në informacionin e paraqitur në vijim, janë si më poshtë:


1. **Fondacioni ABC është angazhuar gjatë periudhës së vitit 2025 në realizimin e 6 projekteve, prej të cilave:**
 - 1 “projekt fitues” të dalë nga procesi standart i vlerësimit/rekomandimit të Komisionit Seleksionues të Fondacionit Albanian Besa Capital;
 - 3 projekte të natyrës “marrëveshje granti” dhe/ose sponsorizime;
 - 2 projekte të natyrës së “granteve të emergjencës”.
- 2 **Vlera totale e kontratave/marrëveshjeve të lidhura për 6 projektet e mbështetura është rreth 3,7 milion lekë; Vlera mesatare e projekteve të financuara është rreth 620,000 lekë.**
- 3 **Statusi fizik i 6 projekteve është:**
 - ✓ 5 projekte të përfunduara;
 - ✓ 1 projekt në proces (përfunduar në vitin 2026).

Informacion më i detajuar për secilin projekt të financuar dhe zhvilluar gjatë periudhës së vitit 2025 gjëndet në tabelën Nr.2 më poshtë:

Nr	Grantet sipas natyrës / Titulli i Projektit	Grantëmarrësi	Adresimi Fondeve Grant	Të dhëna Financiare (në Lekë)		Vendi i zbatimit	Statusi i Projekteve Grant
				Nga ABC	Disbursuar		
Projekti Fitues nga Thirrjet e Hapura:							
a.	Sipërmarrja Femërore / Biznesi social			700,000	100%		
1	Art Turizëm	Shoqata Kombëtare për Integrim, Zhvillim dhe Ndhimë për Shtresat në Nevojë “SH.K.I.ZH”	Sipërmarrja femërore/ Biznesi Social	700,000	100%	Rajoni i Kukësit, Tiranë	Përfunduar
b.	Marrëveshje Granti (sponsorizime)			717,000	100%		
2	Trajnim i Stafit Drejtues të Fondit Besa mbi	Fondi Besa	Ndërtim kapacitetesh	170,000	100%	Tiranë	Përfunduar

Nr	Grantet sipas natyrës / Titulli i Projektit	Grantëmarrësi	Adresimi Fondeve Grant	Të dhëna Financiare (në Lekë)		Vendi i zbatimit	Statusi i Projekteve Grant
				Nga ABC	Disbursuar		
	“Drejtimin, Menaxhimin e Ekipit”						
3	Mobilimi i zyrave të reja të Shoqatës (AMA)	Shoqata Mikrofinanca Shqiptare	Përmirësim i infrastrukturës mbështetëse	98,000	100%	Tiranë	Përfunduar
4	“Gjeneza e besimit, riskut, kredise” dhe “Menaxhimi në Mikrofinancë”	Adnand Zaloshnja	Botime për Kërkime dhe Studime akademike	449,000	100%	Tiranë	Përfunduar
c.	Grante Emergjence/të tjera			2,290,190	100%		
5	Për ribrandimin dhe promovimin e imazhit të ri të ASF	Agro Social Fund	Përmirësim i infrastrukturës mbështetëse	2,000,000	100%	Tiranë, Shkodër, Lezhë, Lac, Durrës, Elbasan, Librazhd, Lushnje, Fier, Pogradec, Bilisht, Korçë	Në proces
6	Panairi i produkteve artizanale të Bashkisë Skrapar “Skrapari në Gotë”	Bashkia Skrapar	Mbështetje për Institucionet publike	290,190	100%	Skrapar	Përfunduar
TOTAL PROJEKTE				3,707,190	100%		

Përqindja sipas adresimit të Fondeve Grant për periudhën Janar - Dhjetor 2025




Grafiku paraqet shpërndarjen e fondeve të grantdhënies të realizuar gjatë periudhës janar – dhjetor 2025, sipas mbështetjes financiare të dhënë nga Fondacioni Albanian Besa Capital. Nga analiza e të dhënave rezulton se pjesa më e madhe e fondeve është adresuar për përmirësimin e infrastrukturës mbështetëse, me një vlerë prej 2,098,000 lekë, që përfaqëson 56% të totalit të fondeve të alokuara. Kjo është pasuar nga mbështetja për sipërmarrjen femërore/biznesin social, me 700,000 lekë ose 19% të totalit.

Gjithashtu, fondacioni ka mbështetur financimin e botimeve për kërkime dhe studime akademike me 449,000 lekë (12%), ndërsa mbështetja për institucionet publike ka zënë 8% të fondeve, në vlerën 290,190 lekë. Një pjesë më e vogël e financimit, prej 170,000 lekë ose 5%, është dedikuar për ndërtimin e kapaciteteve.


Në total, gjatë vitit 2025 janë adresuar 3,707,190 lekë nëpërmjet instrumenteve të grantdhënies/sponsorizimeve, duke reflektuar një fokus të veçantë në investimet infrastrukturore, por njëkohësisht duke siguruar mbështetje edhe për zhvillimin ekonomik, forcimin institucional dhe promovimin e dijes dhe kërkimit.

Implementimi i Granteve për vitin 2025



Për vitin 2025, rezulton se 27,8% e granteve janë implementuar në Tiranë, ndërsa 5,6% janë realizuar në qytetet e tjera, përkatësisht Kukës, Shkodër, Lezhë, Laç, Durrës, Elbasan, Librazhd, Lushnjë, Fier, Pogradec, Bilisht, Korçë dhe Skrapar.

Zonat e implementimit të Granteve për vitin 2025



Shtrirja gjeografike e projekteve të mbështetura në vitin 2025 tregon një prezencë të gjerë territoriale të programit të granteve. Kjo shpërndarje dëshmon për përpjekjen e Fondacionit për të garantuar një mbulim sa më të balancuar dhe gjithëpërfshirës të ndërhyrjeve, duke mbështetur iniciativa zhvillimore jo vetëm në qendrën kryesore urbane, por edhe në zona të tjera të vendit.

Për sa më sipër, gjatë periudhës janar – dhjetor 2025, Fondacioni Albanian Besa Capital ka arritur të forcojë ndikimin e tij në disa fusha prioritare të zhvillimit, nëpërmjet mbështetjes financiare të ofruar përmes programeve të grantdhënies dhe marrëveshjeve të grantit.

Këto ndërhyrje dëshmojnë rolin e rëndësishëm të programit të grantdhënies si një instrument për nxitjen e zhvillimit ekonomik, social dhe kulturor në vend. Nëpërmjet mbështetjes së gjashtë iniciativave në fusha të ndryshme, Fondacioni Albanian Besa Capital ka kontribuar në rritjen e kapaciteteve institucionale, përmirësimin e infrastrukturës, promovimin e sipërmarrjes dhe dijes, si dhe në forcimin e bashkëpunimit me aktorë të ndryshëm publikë dhe jopublikë, duke rritur qëndrueshmërinë dhe ndikimin e subjekteve të mbështetura.

➤ **AKTIVITETI INVESTUES, FINANCIAR DHE EKONOMIK.**

Për realizimin e objektivit të tij, nevojat financiare të Fondacionit ABC gjatë vitit 2025 janë plotësuar nga të ardhurat prej pasurisë së Fondacionit dhe aktivitetit të tij ekonomik.

Fondacioni ABC është aksioneri kryesor i shoqërisë Fondi Besa sh.a.

Ne vitin 2023, me qëllim realizimin e të ardhurave nga investimet në pjesëmarrje për venien e këtyre të ardhurave në funksion të veprimtarisë së grantdhënies, Fondacioni ABC ka vlerësuar të rrisë investimin e tij në sipërmarrje të huaja jashtë vendit, nëpërmjet investimit në shoqërinë **MICROSMART MFI SA**, me vend të ushtrimit të veprimtarisë në Selanik –GREQI, në të cilën Fondacioni ABC është themelues dhe pjesëmarrës në kapital me 66.25 % të kapitalit themelues.

Gjatë vitit 2025, Fondacioni ABC ka themeluar shoqërinë Besa Alb Real Estate sh.p.k me pjesëmarrjen në masën 100% të kapitalit të shoqërisë.

Për realizimin e të ardhurave me qëllim përdorimin e tyre për financime në mbështetje të veprimtarisë së tij jofitimprurëse, Fondacioni ABC ka lidhur 2 marrëveshje huadhënieje me shoqërinë aksionere Fondi Besa sh.a., në vlerën totale 1,901,685,558.⁵⁵ Lekë.

➤ RAPORTIMI FINANCIAR

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Drejtuar drejtimit te shoqërise "Fondacioni "Albanian Besa Capital"

Opinionit

Ne kemi audituar Pasqyrat financiare bashkëlidhur të shoqërisë Fondacioni "Albanian Besa Capital" të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 Dhjetor 2025, pasqyrën e performancës, pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare dhe pasqyrën e ndryshimit të kapitaleve të veta për vitin që mbyllet në këtë datë, si dhe shënimët lidhur me këto pasqyra financiare dhe një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur, në të gjitha aspektet materiale, japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë për pozicionin financiar të shoqërisë Fondacioni "Albanian Besa Capital" më 31 Dhjetor 2025, të performancës financiare dhe flukseve të parasë për ushtrimin që mbyllet në këtë datë, pasqyra të cilat janë përgatitur në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit të përmiresuara .

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshlatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Informacione të tjera

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, përgjegjësia jonë është të lexojmë informacionet e tjera dhe duke bërë këtë, të konsiderojmë nëse informacioni tjetër është dukshëm jo konsistent me pasqyrat financiare ose bazuar në njohuritë tona të marra gjatë auditimit, të vlerësojmë nëse ato dukshëm janë paraqitur me anomali materiale. Në qoftë se, bazuar në punën që ne kemi kryer, ne arrijmë në konkluzion se gjenden anomali materiale në këto informacione, ne do të raportojmë këtë fakt. Sa më sipër ne nuk kemi gjë për të raportuar.

Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të Fondacioni "Albanian Besa Capital" janë të përgatitura në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 janë audituar nga një auditues tjetër, i cili ka lëshuar raportin e audituesit të pa modifikuar më datë 26 Mars 2025.

Theksim i çështjes – Rivlerësimi i aktiveve të shoqërisë

Ne tërheqim vëmendjen për Shënimin 4.1.6.b të pasqyrave financiare, ku theksohet se megjithëse ka indikacione për zhvlerësim të investimit në pjesëmarrjen në kapitalin e shoqërisë BAI sh.p.k, në vlerën 465,961,782 lekë, shoqëria nuk mund të njohë një zhvlerësim të investimit për sa kohë që shoqëria nuk mund të masë me besueshmeri vlerën e asetëve pasi nuk ka akoma një vlerësim të certifikuar nga ekspert vlerësues apo të jetë realizuar shitja e tyre. Opinioni ynë nuk është modifikuar për sa i përket kësaj çështjeje.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK-të të përmiresuara, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një e auditimi në pajtim me SNA-të, audituesi ushtron gjykimin profesional dhe mban skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit.

Në një auditim përgjegjësitë e audituesit janë:

(i) Të identifikojë dhe të vlerësojë rreziqet e anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë nga mashtrimi apo gabimi; të hartojë dhe kryejë procedura auditimi në përgjigje ndaj këtyre rreziqeve; dhe, të marrë evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin e audituesit. Rreziku moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë sesa rreziku që rrjedh nga gabimi, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përfshajtje të qëllimshme, informacione të déformuara, ose anashkalime të kontrolleve të brendshme.

(ii) Të sigurojë njohjen dhe kuptimin për kontrollin e brendshëm që lidhet me auditimin, në mënyrë që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo me qëllimin për të shprehur një opinion lidhur me efektivitetin e funksionimit të kontrollit të brendshëm të entitetit. Në rrethanat kur audituesi ka edhe përgjegjësinë për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e funksionimit të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, audituesi do të heqë frazën ku theksohet se marrja në konsideratë e kontrollit të brendshëm nga audituesi nuk ka si qëllim shprehjen e një opinionit mbi efektivitetin e funksionimit të kontrollit të brendshëm.

(iii) Të vlerësojë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e çmuarjeve (vlerësimeve) kontabël dhe informacioneve shpjeguese përkatëse të dhëna nga drejtimi.

(iv) Të arrijë në një konkluzion lidhur me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijmësisë nga ana e drejtimit dhe, bazuar në evidencën e auditimit të siguruar, të vlerësojë nëse ekziston një pasiguri materiale lidhur me ngjarje ose rrethana të cilat mund të hedhin një dyshim të madh për aftësinë e entitetit për të vijuar veprimtarinë. Nëse audituesi arrin në konkluzionin se ekziston një pasiguri materiale, ai është i detyruar të tërheqë vemendjen në raportin e audituesit, lidhur me informacionet shpjeguese përkatëse të dhëna në pasqyrat financiare ose, nëse këto informacione shpjeguese nuk janë të përshtatshme, të modifikojë opinionin. Konkluzionet e audituesit bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit të audituesit. Megjithatë, ngjarje ose rrethana të ardhshme mund të bëjnë që entiteti të ndalojë së vijuari veprimtarinë.

(v) Kur pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me një kuadër të paraqitjes së drejtë, të vlerësojë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet mbështetëse në një mënyrë të atillë që arrihet paraqitja e drejtë.

Tirane me, 26/03/2026

Enkeleda Stefani
Audituesi Ligjor

Adresa: Rruga e Durrësit Nr.Pazurie 8/374.ND+2- 28/4 . Zona Kadastrale 8310 , Tirane

e-mail: enkeleda_m@yahoo.com
Mobile: 00355 68 2005013



PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR 31 DHJETOR 2025			
AKTIVET		31/12/2025	31/12/2024
AKTIVET			
	Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	9,772,453	12,011,577
	Të drejta dhe interesi I arkëtueshëm	78,751,255	51,211,305
	Kontribute të arkëtueshme		
	Inventarë dhe shpenzime të parapaguara	2,419,250	8,342,750
	Investime financiare afatgjata	1,953,685,559	1,910,185,559
	Aktive të kufizuara për investime në toka, ndërtesa dhe paisje		
	Toka, ndërtesa dhe paisje	2,756,934	3,748,963
	Investime të tjera afatgjata	3,442,277,932	3,324,402,535
	TOTALI I AKTIVEVE	5,489,663,383	5,309,902,689
DETYRIMET			
	Të pagueshme	3,292,616	6,487,712
	Dëftesa të pagueshme		
	Kontribute të marra në avancë		
	Grante		
	Premtime të kushtëzuara për të dhënë		
	Hua afatgjatë		
	TOTALI I DETYRIMEVE	3,292,616	6,487,712
AKTIVET NETO			
	Të kufizuara	2,031,092,042	2,031,092,042
	a) Tokë ose vepra arti të dhuruara për t'u përdorur për qëllime specifike me përcaktimin që të ruhen apo të mos shiten		
	b) Aktive të dhuruara me qëllimin për t'u investuar dhe siguruar prej tyre burime të përhershme të ardhurash	2,031,092,042	2,031,092,042
	Të pakufizuara	3,455,278,725	3,272,322,935
	TOTALI I AKTIVEVE NETO	5,486,370,767	5,303,414,977

PASQYRA E AKTIVITETEVE (PERFORMANCËS) 31 DHJETOR 2025			
Nr.	Përshkrimi i zërit	31/12/2025	31/12/2024
	Ndryshimi nga aktivet neto të pakufizuara:		
	Të ardhurat:		
▶	Të ardhura nga tarifat e anëtarësimit		
▶	Të ardhura nga donacionet dhe kontributet vullnetare		
▶	Të ardhura nga grantet qeveritare apo nga agjenci të tjera të financimit		
▶	Të ardhura nga investimet apo dhurimet	275,550,684	266,265,576
▶	Tarifat për shërbimet		
▶	Të ardhura nga aktivitetet tregtare		
▶	Të ardhura të tjera	8,333	0
	Totali I të ardhurave nga aktivet neto të pakufizuara	275,559,017	266,265,576
	Aktive neto të çliruara nga kufizimet:		
	Realizimi I kufizimeve të programit		
	Realizimi I kufizimit për blerjen e paisjeve		
	Përfundimi I kufizimit të afatit		
	Totali I aktiveve neto të çliruara nga kufizimet		
	Totali I të ardhurave nga aktivet neto të pakufizuara:	275,559,017	266,265,576
	Shpenzime për aktivitetet	(3,707,190)	0
	Aktiviteti Jofitimprurës - Grantdhënia	(3,707,190)	0
	Aktiviteti Jofitimprurës - Grante të marra	0	0
	Shpenzime administrimi dhe të tjera të përgjithshme	(88,896,037)	(80,635,632)
	Krijim dhe rritje fondesh		
	Totali I shpenzimeve	(92,603,227)	(80,635,632)
	Rritja/rënia në aktivet neto të pakufizuara (A)	182,955,790	185,629,944
	Ndryshimi në aktivet neto të kufizuara:		
	Kontributet		
	Të ardhura nga investimet afatgjata		
	Të ardhura nga investimet afatgjata		
	Fitimi I realizuar dhe I porealizuar nga investimet afatgjata		
	Humbja aktuariale nga obligacioni vjetor		
	Aktivitet neto të çliruara nga kufizimet (me shenjë minus)		
	Rritja/rënia në aktivet neto përkohësisht të kufizuara (B)		
	Ndryshimi në aktivet neto (A+B)	182,955,790	185,629,944
	Aktive neto në fillim të vitit	5,303,414,977	5,121,510,036
	Aktive neto ne fund te vitit	5,486,370,767	5,303,414,977

PASQYRA E FLUKSEVE TË MJETEVE MONETARE - 31 DHJETOR 2025		
AKTIVITETET E SHFRYTËZIMIT	31/12/2025	31/12/2024
Ndryshimet në aktivet neto	182,955,790	185,629,944
Rregullimet për përputhjen e ndryshimeve në aktivet neto me flukset neto nga aktivitetet e shfrytëzimit:	1,053,860	1,020,192
Amortizimi dhe zhvlerësimi	1,053,860	1,020,192
Humbjet e realizuara dhe të porealizuara në investime		
Humbjet nga dalja jashtë përdorimit e makinerive pajisjeve		
Kontributet jo në para		
Rritjet/Rëniet jo në para të inventarëve		
Kontributet e kufizuara për investime në dhurime/ndihma	0	0
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet afatshkurtra	(24,811,545)	(79,498,519)
Të tjera të arkëtueshme	(27,539,949)	(47,748,439)
Shpenzime të parapaguara	5,923,500	(8,342,750)
Bamirësi në mirëbesim të arkëtueshme		
Të pagueshme	(3,195,095)	(23,407,331)
Bamirësi mbi baza vjetore	0	0
Flukse neto nga aktivitetet e shfrytëzimit	159,198,105	107,151,617
AKTIVITETET INVESTUESE		
Blerje/Shitje investimesh	(117,875,397)	(127,294,374)
Blerje/Shitje e Aktiveve afatgjata	(61,831)	(185,530)
Principal I arketuar nga dëftesat e arkëtueshme		
Të arkëtuara në avancë nga dëftesa të arkëtueshme		
Flukse neto nga aktivitetet investuese	(117,937,228)	(127,479,904)
AKTIVITETET FINANCUESE		
Arkëtime nga kontributet e kufizuara për investime në dhurime/ndihma	(0)	(3,725,003)
Principal I paguar për dëftesat e pagueshme	(43,500,000)	14,500,000
Flukse neto nga aktivitetet financuese	(43,500,000)	10,774,997
Rritje/Rënie neto e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre	(2,239,124)	(9,553,290)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fillim të periudhës	12,011,577	21,564,867
Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre në fund të periudhës	9,772,453	12,011,577
Mjete monetare të paguara gjatë periudhës për interesa		
Mjete monetare të paguara gjatë periudhës për tatim taksa		

➤ STRUKTURA, DREJTIMI DHE MBIQYRJA

Fondacioni “ALBANIAN BESA CAPITAL” është person juridik. Ai ka organizimin e tij të brendshëm dhe zgjedh organet drejtuese të tij.

Organet drejtuese

Organet drejtuese të Fondacionit janë:

- Bordi Drejtues
- Drejtori Ekzekutiv

Bordi i Fondacionit. Kompetencat

Bordi i Fondacionit përbëhet nga një minimum prej tre dhe një maksimum prej shtatë anëtarësh. Bordi ka kompetencat e mëposhtme:

1. Është organi më i lartë drejtues vendimmarrës i Fondacionit;
2. Bën ndryshimet në Statut vetëm me miratimin e themeluesit;
3. Harton dhe miraton Rregulloret e Fondacionit, si dhe aktet e tjera të cilat konsiderohen të nevojshme për përmbushjen e objektivave dhe qëllimeve të Fondacionit;
4. Miraton strategjinë, buxhetin dhe planet vjetore të punës;
5. Në ushtrimin e kompetencave të veta nxjerr norma për rregullimin e veprimtarisë, organizimit dhe strukturës së Fondacionit;
6. Emëron dhe shkarkon Drejtorin Ekzekutiv;
7. Përcakton udhëzuesit e Pergjithshëm të punësimit, si dhe çdo shpenzim që tejkalon buxhetin e miratuar nga ana e tij;
8. Analizon dhe aprovon raportet e aktivitetit të propozuara nga Drejtori Ekzekutiv;
9. Ka të drejtë të krijojë komitete, të caktojë dhe të heqë anëtarët e tyre;
10. Mbyll aktivitetin e Fondacionit vetëm pasi ka marrë miratimin e themeluesit.

Bordi Drejtues i Fondacionit ABC përbëhet nga:

1 - Altin Muça	Kryetar I Bordit Drejtues – afati deri më 13/01/2029
2 - Irma Disha	Anëtare - afati deri më 13/01/2029
3 - Valbona Xhafa	Anëtare - afati deri më 13/01/2029
4 - Arjola Stafa	Anëtare - afati deri më 15/12/2026
5 - Valbona Greva	Anëtare - afati deri më 15/12/2026

Drejtori Ekzekutiv

Statusi i Drejtorit Ekzekutiv përcaktohet si më poshtë:

- a. Është përfaqesuesi i Fondacionit përpara organeve të ndryshme shtetërore, përpara Gjykatës, si dhe përpara të tretëve;
- b. Emërohet dhe shkarkohet nga Bordi me 2/3 e votave të gjithë anëtarëve;
- c. Mandati i Drejtorit Ekzekutiv do të jetë për një periudhë të pacaktuar;
- d. Drejtor Ekzekutiv i Fondacionit “ALBANIAN BESA CAPITAL” është Z. Bajram MUÇAJ.

Struktura e Burimeve Njerëzore gjatë vitit 2025

Nr.	Departamenti	Pozicioni I punës	Nr. Punonjës gjatë periudhës
1	Zyra e Drejtorit Ekzekutiv	Drejtor Ekzekutiv	1
2	Departamenti i Financës, Burimeve Njerëzore, Shërbimeve	Drejtor i Financës	1
		Shofer	1
		Pastruese	1
		Punonjës shërbimi	1
3	Departamenti i Programeve & Marketingut	Zëvendës Drejtor Ekzekutiv & Drejtor i Programeve	1
		Koordinatore e Projekteve	1
		Specialiste e projekteve	1
Total			8

➤ SYNIMET PËR TË ARDHMEN PËR VITIN 2026

Fondacioni ABC, në përmbushje të misionit të tij vijon të jetë një partner i rëndësishëm në zhvillimet e komunitetit të biznesit, në mbështetje të nevojave të shoqërisë civile dhe të grupeve në nevojë. Fondacioni ABC nëpërmjet iniciativave të tij bashkëpunuese do të jetë një partner i rëndësishëm edhe për periudhat në vijim.

Për vitin 2026, Fondacioni ABC parashikon një buxhet total prej 12,500,000 Lekë, për mbështetjen financiare në realizimin e rreth 16 projekteve, në përgjigje të kërkesave të shoqërisë civile, strukturave të biznesit dhe atyre publike.

Mbështetur në nevojat reale të shoqërisë shqiptare, në konsultimet me stafin teknik, vendimmarrësit, partnerët institucionalë dhe aktorët lokalë, si dhe në analizën e materialeve strategjike mbi zhvillimin e biznesit, shoqërisë civile dhe strukturave vendore, Fondacioni ABC orienton mbështetjen financiare në formë grantesh, sipas drejtimit dhe prioritetëve të përcaktuara në këtë Program.

Sikurse është theksuar më sipër, gjatë vitit **2026** Fondacioni ABC do të fokusohet në përmbushjen e objektivave institucionale në këto drejtime kryesore:

- A. Përmirësimi i klimës së biznesit në Shqipëri;
- B. Ndërtimi dhe fuqizimi i kapaciteteve në fushën e mikrofinancës;
- C. Mbështetja e shoqërisë civile dhe grupeve vulnerabël;
- D. Zhvillimi i agroturizmit dhe turizmit lokal si instrument për zhvillim ekonomik dhe mjedisor.

Financimi i projekteve sipas aktiviteteve të mësipërme do të mbështetet në “*Procedurat e Grantdhënies*” të Fondacionit ABC.

Programet grant do të bëjnë të mundur financimin dhe zbatimin e aktiviteteve dhe/ose projekteve specifike. Fondet grant do të adresohen në një fushë gjithëpërfshirëse, si më poshtë:

A. Përmirësimi i klimës së biznesit në Shqipëri

Fondacioni ABC, për vitin 2026, do të fokusohet në mbështetjen financiare për “Përmirësimin e Klimës së Biznesit”, në dy drejtime kryesore:

1. Programe grant për nxitjen dhe zhvillimin e sipërmarrjes rinore për ngritjen e një biznesi të ri “start-up”;
2. Mbështetjen e sipërmarrjes femërore orientuar në Biznesin Social, me synim përmirësimin e statusit social-ekonomik të tyre.

Në funksion të qëllimeve të sipërpërmendur për përmirësimin e klimës së biznesit në Shqipëri, Fondacioni ABC synon të jetë mbështetës dhe bashkëpunues, për rezultate të prekshme dhe konkrete. Për këtë qëllim do të gjallërohen të gjitha komunikimet dhe partneritetet e mundshme me institucionet vendore, publike dhe private, të përfshira aktivisht në jetën e biznesit në vend.

B. Ndërtimi dhe fuqizimi i kapaciteteve në fushën e mikrofinancës

Gjatë vitit 2026, Fondacioni ABC do të mbështesë financimin, nëpërmjet fondeve grant, për projekte, aktivitete dhe iniciativa që i përkasin ndërtimit të kapaciteteve për sektorin e mikrofinancës. Ky program do të jetë një nga prioritetet, duke qenë se në sektorin mikrofinanciar, roli i ndërtimit dhe rritjes së kapaciteteve është shumë më i rëndësishëm, pasi ai ka të bëjë drejtpërdrejt me aspektet e sjelljes së njerëzve dhe klientëve që formëson vlerat organizative. Për realizimin e këtij projekti, Fondacioni do të fokusohet në tre fusha kryesore si më poshtë:

1. Realizimi i studimeve, kërkimeve dhe mbështetje për IMF-të;
2. Trajnime për IMF-të;
3. Mbështetje financiare për marketingun.

Për secilin prej komponentëve të mësipërm është krijuar një eksperiencë e vyer përsa i përket konkretizimit të planit dhe/ose veprimeve të mbështetjes, eksperiencë e cila aktualizohet në vijimësi në varësi të nevojave reale të sektorit.

C. MBESHTETJE E SHOQËRISË CIVILE DHE GRUPEVE VULNERABËL

Mbështetja për iniciativat e shoqërisë civile dhe grupeve vulnerabël do të realizohet nëpërmjet implementimit të “programeve grant”, të cilat do të mundësojnë realizimin e projekteve specifike në këtë kuadër. Këto projekte do të realizohen duke u bazuar në procedurat e grantdhënies. Programet grant do të adresohen në një fushë gjithëpërfshirëse, si më poshtë:

1. Programe grant për nevojat e moshës së tretë;
2. Mbështetje financiare për fëmijët në nevojë.

Ky objektiv do të realizohet në bashkëpunim me shoqatat e përfshira në mbështetje të grupeve vulnerabël, të cilat kanë pasur rezultate konkrete në këtë kuadër. Ndërkohë, edhe bashkëpunimi me strukturat vendore do të jetë një domosdoshmëri për të siguruar harmonizimin dhe realizimin e këtij projekti.

Në përgjigje të nevojave të vazhdueshme të shoqërisë shqiptare për më shumë vëmendje ndaj njerëzve në nevojë, si dhe në përputhje me politikat e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Fondacioni ABC do të vijojë të mbështesë me “programe grant” grupet vulnerabël. Programi mbetet aktual dhe i bazuar si në kërkesat e larta të shoqërisë civile, të paraqitura periodikisht pranë Fondacionit ABC gjatë këtyre viteve të aktivitetit të tij, ashtu dhe në objektivat e vetë Fondacionit.

Ky program, i cili trajton dhe përfshin një pjesë të konsiderueshme të grupeve vulnerabël, të lejon që për efekte metodologjike dhe mirëadministrimi të procesit të grantdhënies, të detajohet dhe më pas të shpallet për publikun në formën e fushave specifike të adresuara qartë, për njërin apo tjetrin grup vulnerabël.

D. ZHVILLIMI I AGROTURIZMIT DHE TURIZMIT LOKAL SI INSTRUMENT PËR ZHVILLIM EKONOMIK DHE MJEDISOR

Zhvillimi i agroturizmit dhe turizmit lokal në Shqipëri përbën një mundësi strategjike për të nxitur zhvillimin ekonomik, mbrojtjen e mjedisit dhe forcimin e komuniteteve rurale. Mbështetja financiare për projekte të tilla është thelbësore për arritjen e rezultateve të qëndrueshme dhe të matshme në këto fusha.

Agroturizmi dhe turizmi lokal krijojnë mundësi të drejtpërdrejta për të ardhura për familjet dhe komunitetet rurale. Këto aktivitete ofrojnë punësime sezonale dhe afatgjatë, mbështesin sipërmarrjen e vogël dhe promovojnë prodhimet lokale (ushqimore, artizanale, kulturore). Fonde grant ndihmojnë në financimin e infrastrukturës, trajnimeve dhe promovimit të shërbimeve turistike, duke bërë projektet të qëndrueshme dhe konkurrueshme.

Turizmi i qëndrueshëm dhe agroturizmi promovojnë praktika miqësore me mjedisin, duke minimizuar ndikimin negativ të aktivitetit ekonomik mbi natyrën. Investimi në projekte të tilla ndihmon në mbrojtjen e burimeve natyrore, pyjeve, lumenjve dhe peizazheve rurale, duke krijuar një balancë midis zhvillimit ekonomik dhe ruajtjes së mjedisit.

Agroturizmi dhe turizmi lokal nuk janë vetëm shërbime ekonomike; ato gjithashtu promovojnë dhe ruajnë traditat, zakonet dhe trashëgiminë kulturore të komuniteteve rurale.

Fondacioni ABC ofron mbështetje dhe bashkëpunon me organet e qeverisjes vendore dhe grupet e interesit, për të trajtuar çështje të ndjeshme dhe me interes për një komunitet apo lokalitet të caktuar. Në përgjigje të nevojave të vazhdueshme të shoqërisë shqiptare për më shumë vëmendje ndaj problematikave të hasura në komunitet, Fondacioni ABC nëpërmjet fondeve grant për projekte që i përkasin sektorit të agroturizmit, do të ofrojë mbështetjen e tij në dy drejtime kryesore:

1. Forcimi i kapaciteteve turistike familjare dhe komunitare në zonat rurale dhe ekonomisë lokale;
2. Promovimi i projekteve që ndërthurin zhvillimin ekonomik me ruajtjen e mjedisit dhe trashëgimisë kulturore.

Projektet e agroturizmit dhe turizmit lokal që mbështeten me grant nxisin bashkëpunimin mes komuniteteve, bizneseve dhe autoriteteve lokale. Kjo krijon rrjete mbështetëse dhe përforcon identitetin lokal, duke bërë që zhvillimi ekonomik të ketë ndikim pozitiv për të gjithë anëtarët e komunitetit.

Drejtori Ekzekutiv

Prof. Asoc. Dr. Bajram MUÇAJ

